REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 981/20
Date/Datum 04.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Shkurte Jashanica	*25.11.2020*	*04.12.2020*	981/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.11.2020 OE"OntexiMontSh.p.k" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 981/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Grryerja e parktetit në palestren sportive 1 Tetori**" me nr. të prokurimit:"**QS 20-027-521**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Qendra e Studenteve e Universitetit të Prishtines".
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurëtë hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 27 000,00.
Me datën 07.11.2020 është bërë kërkesa për Rishqyrtim nga ana e Operatorit Ekonomik "OntexiMontSh.p.k"
Me datën 10.11.2020 nga Autoriteti Kontraktues është bërë refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Ekspertja ShqyrtueseProfesionale e Prokurimit Publik, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Tëpërshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 - i LPP-së
Neni 6 - i LPP-së
Neni 7 - i LPP-së
Neni 28 - i LPP-së
Neni 60- i LPP-së
Neni 61 - i LPP-së
Neni 68 - i LPP-së
Neni 69 - i LPP-së

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi Shkurte Jashanica	*Data e autorizimit të ekspertit 25.11.2020*	*Data e dorëzimit të raportit 04.12.2020*	Nr. i lëndës:981/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.11.2020 OE"OntexiMontSh.p.k" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 981/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Grryerja e parktetit në palestren sportive 1 Tetori"** me nr. të prokurimit:**"QS 20-027-521**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Qendra e Studenteve e Universitetit të Prishtines".
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurëtë hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 27 000,00.
Me datën 07.11.2020 është bërë kërkesa për Rishqyrtim nga ana e Operatorit Ekonomik "OntexiMontSh.p.k"
Me datën 10.11.2020 nga Autoriteti Kontraktues ështe bërë refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Ekspertja ShqyrtueseProfesionale e Prokurimit Publik, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Tëpërshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 - i LPP-së
Neni 6 - i LPP-së
Neni 7 - i LPP-së
Neni 28 - i LPP-së
Neni 60- i LPP-së
Neni 61 - i LPP-së
Neni 68 - i LPP-së
Neni 69 - i LPP-së

KRITERET PËR VLERËSIM

Deklarata nën betim, qe tenderuesi i plotëson kërkesat mbi përshtatshmërinë ne pajtim me Ligjin Nr04L-042 Dëshmia e kërkuar dokumentare: Deklarata nën betim, qe tenderuesi i plotëson kërkesat mbi përshtatshmërinë ne pajtim me Ligjin Nr04L-042 Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes).

Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime borxhe te tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet te jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës

Vërtetimi i ATK (i verifikuar ne ëeb faqen e ATK-se).

Dëshmi se kompania (biznesi) nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë te lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjeter se 180 dite nga data e leshimit deri ne diten e dhenies.

Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar

Përshtatshmëria profesionale: Dëshmia e kërkuar dokumentare: Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit (kopje). Çertifikata e regjistrimit te biznesit, se ashku me dokumentin Informatë mbi Bizneset kopje Çertifikat

Çertifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e përfshire ne certifikaten e biznesit (kopje). Çertifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e ërfshire ne certifikaten e biznesit (kopje). Çertifikataper Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK (kopje). Çertifikataper Regjistrim në TVSH (kopje).

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Dëshmia e kërkuar dokumentare: Operatori ekonomik duhet te ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë prej jo më pak se 40,000.00 euro Dokument nga banka për qarkullimin e OE në tri vitet e fundit, ose pasqyrat e auditura financiare për tri vitet e fundit ose dekleratat vjetore tatimore te dorezuara ne ATK per tri vitet e fundit.

Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare: Operatori Ekonomik duhet te ofroje deshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne tre vitet e fundit deri ne daten e ketij njoftimi, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre

projekteve. Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit deri ne daten e ketij njoftimi dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbalet e pranimit te puneve. OE duhet të ofroj një deklarta me shkrim për realizimin e projektit sipas specifikimeve teknike. OE duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për realizimin e/ projektit sipas specifikimeve teknike në formë projekti mbi menyren e organizimit të punëve dhe realizimin e kontratës.
Personeli i operatorit ekonomik, listen e punetoreve qe jane te perfshiredrejperdrejt ne realizimin e ketyre punimeve.

Operatori ekonomik duhet te deshmoje se ka te angazhuar (ose do t'i angazhoj) se paku 5 punetor (listen e punetoreve).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Ontexi Mont"Sh.p.k **-Prishtinë**

Përgjigje lidhur me pretendimet e Operatorit Ekonomik Ankues.

Ekspertja Shqyrtuese Profesionale e Prokurimit Publik, fillimisht sqaron për Operatorin Ekonimik Ankues se Autoriteti Kontraktues, pas rivlereësimit të tenderit, ka vazhduar procedurat e prokurimit në bazë të Ligjit për Prokurim Publik lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Duke mos anashkaluar asnjë pikë në bazë të LPP-së dhe duke vepruar në harmoni të plotë të këtij ligji.

Ekspertja shqyrtuese konstanton se në bazë të dokumenteve të poseduara, Operatorit Ekonomik ankues iu është lejuar qasja në dokumentacione për procedurën e prokurimit publik të lartë përmendur.
Lidhur me pretendimin ankimor ku thuhet se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat për specifikime teknike, ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik dhe konkretisht ligjin nr. 04/L – 042 ku njëherit lejohet plotësimi i dokumentacionit shtesë, Autortiteti kontrkatues pas kërkesës së OSHP-së për rivlerësimin e procedurës për këtë aktivitet të prokurimit, vjen në përfundim se ka vepruar në harmoni me rregullat e LPP-së dhe se pretendimi i Operatorit Ekonomik Ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor ku thuhet se OE fitues nuk ka ofruar punëtorë të mjaftueshëm, sqarojmë se pas rivlereësimit Autoriteti Kontraktues ka vepruar në bazëtë LPP-së, pasi që ka përzgjedhur OE për kontratë i cili i plotëson kërkesat sipas pikave në njoftimin për kontratë. Andaj bazuar në dokumentacionet dëshmi, edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor ku thuhet se AK ka përzgjedhur OE fitues njëherit i cili ka ofruar çmim më të ulët për këtë aktivitet të prokurimit, duke u bazuar në dokumentacionin që OE fitues ka ofruar dhe në dokumentacionet e AK-së ku asnjë Operator Ekonomik nuk ka rezultuar të ketë ofruar çmim jo normalisht të ulët, konsiderojmë se edhe në këtë aspekt Autortiteti Kontraktues ka vepruar në harmoni me LPP-në. Ekspertja shqyrtuese konstaton se duke u bazuar në nenin 1 të Ligjit për Prokurim Publik ku thuhet se qëllimi i këtij neni është të sigurojë mënyrën më efikase më transparente dhe me të drejtë që të shfrytëzohen fondet publike, Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka plotësuar kushtet edhe sa i përket çmimit të ofruar për këtë aktivitet të prokurimit publik. Mirëpo kërkojë nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit, që gjatë seancës dëgjimore të kërkoj një lloj shpjegimi nga OE fitues duke na prezantuar një lloj plan programi se si do të arrihen plotësimi i kërkesave në bazë të çmimit të ofertuar.

Duke pasur parasysh se Oferta e Operatorit Ekonomik ankues "OntexiMont" SH.p.k, për plotësimin e kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, ka rezultuar të ketë çmim të lartë, më konkretisht nuk qe tenderi me çmimin më të ulët, përkitazi me nenin 1 të LPP-së. Ekspertja Shqyrtuese Profesionale e Prokurimit Publik Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 ka shiquar, analizuar dhe shqyrtuar pikat ankimore dhe vjen në përfundim duke konsideruar si të pa bazuar ankesën e Operatorit Ekonomik.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, EkspertjaShqyrtuese Profesionale e Prokurimit Publik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, dhe rekomandon që Autoriteti Kontraktues të vazhdojë me hapat e mëtutjeshëm.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – QSUP
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - ONTEXI MONT SH.P.K